



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:279517
Datë: 22.02.2024
Numri i dokumentit: 05361370

E.nr.715/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË / DEGA MALISHEVË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM– DIVIZIONI CIVIL, Përmbartimore, gjyqtari Nehat Qelaj, në çështjen juridike të përmbartimit të kreditorit H.P, Komuna Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Bestar Kolgeci nga Prizreni Rr. “De Rada|” nr. 04 ndaj debitorit Komuna e Malishevës- Drejtoria e Arsimit e përfaqësuar nga avokati publik Mujë Sahitaj, lidhur me përmbartimin e vendimit të inspektoratit të punës në Prizren Nr.382/2021 të datës 31.08.2021 për kompensim e shjrtave ditore me datë 22.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura e përmbartimit në çështjen përmbartimore të kreditorit H.P ndaj debitorit Komuna e Malishevës- Drejtoria e Arsimit, për kompensim të shjrtave ditore sipas vendimit të inspektoratit të punës në Prizren Nr. 382/2021 të datës 31.08.2021, pasi që është përmbushur detyrimi i debitorit ndaj kreditorit me urdhëresën për përmbartim të kësaj gjykate E.nr.715/2021 të datës 24.10.2023.

A r s y e t i m

Kreditori më datë 13.12.2021 në këtë gjykatë përmes të autorizuarit e tij kanë parashtruar propozimin për përmbartim të vendimit të inspektoratit të punës në Prizren Nr. 382/2021 të datës 31.08.2021, e të cilin kjo gjykatë me aktvendimin E.nr.715/2021 të dates 20.09.2023, e lejon përmbartimin e këtij propozimi. Ndaj këtij vendimi nuk është parashtruar prapësim nga debitori prandaj pas plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi, Gjykata me datë 24.10.2023, ka dërguar urdhrin për ekzekutim ne Ministrinë e Financave dhe Transfereve - Thesarit të Kosovës, që të bëjnë ndalesën e mjeteve monetare nga llogaria e debitorit në emër të detyrimit ndaj kreditor të përshkruar si në këtë urdhër për ekzekutim.

Debitori-Komuna Malishevës më anë të parashtrësës datës 16.02.2024 njoftoj Gjykatën se për këtë lëndën përmbartimore është kryer përmbartimi nga thesari qendror sipas vendimeve gjyqësore që gjenden në listë (bashkangjitur parashtrësës).

Gjykata pas shikimit te kësaj liste konstaton së Urdhëri për ekzekutim E.nr.715/2021 të datës 24.10.2023 që ka të bëjë me kreditorin është ekzekutuar.

Numri i lëndës: 2021:279517
Datë: 22.02.2024
Numri i dokumentit: 05361370

Meqenëse i autorizuari i kreditorit përmes parashtresës së lartë cekur e njoftuan gjykatën se kjo lëndë është ekzekutuar gjykata në kuptim të nenit 66 par.4 të LPP-së vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi .

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI CIVIL, Përmbartimore
E.nr.715/2021 datë 22.02.2024

Gj y q t a r i
Nehat Qelaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.